



**Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**

# MARS 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

## MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

### Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë



[ankesa@amp.gov.al](mailto:ankesa@amp.gov.al)



0800 90 90

### Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



[denonco@amp.gov.al](mailto:denonco@amp.gov.al)



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë


### Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë DVP-ve në Qarqe

### Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



[www.amp.gov.al](http://www.amp.gov.al)



## VEPRIME HETIMORE

### Referimet e bëra në Prokurori

**11** referime në Prokurori për **11** punonjës të Policisë së Shtetit, **1** punonjës i Gardës së Republikës dhe **6** shtetas për vepra të ndryshme penale.

### Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

- **Vendosur caktimi i masës ndaluese "Arrest në burg";**  
2 punonjës policie
- **Vendosur caktimi i masës së sigurimit personal "Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore";**  
1 shtetas

## INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Mars janë kryer **4 inspektive**, prej të cilave;

- 2 të planifikuara sipas Programit Vjetor të Inspektiveve të AMP-së, kryer në strukturat e Kufirit dhe Migracionit,
- 2 të paplanifikuara, të iniciuara nga ankesat e qytetarëve, të cilat i janë nënshtruar hetimit administrativ dhe ankuesit i është kthyer përgjigje mbi përfundimet e inspektimit.

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar për muajin Mars në total **7 praktika disiplinore**, nga të cilat në 6 raste ka konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 7 punonjës policie, ndërsa në 1 rast ka konstatuar dhe vendosur dërgimin e praktikës për kompetencë, si më poshtë:

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Shtyrje të afatit të gradimit për 1 vit".
- Në 1 rast, për 2 punonjës policie, Komisioni ka vendosur pezullimin e hetimit disiplinor deri në përfundim të hetimit penal.
- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor pa shkelje administrative.
- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor dhe rekomandimin për shkelje të lehtë.
- Në 2 raste, për 2 punonjës policie, Komisioni ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor për shkelje të rëndë.
- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni ka vendosur dërgimin e praktikës për kompetencë DPPSH-së për shkak të pozicionit si punonjës administrative.

## HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun



**301 Telefonata**

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat;

**157** telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)  
**55** telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)  
**89** telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



## Ankesa të trajtuara

**126 ankesa**

- Në **23** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të drejta
- Në **77** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të pabazuara
- Në **25** raste, ankesat e qytetarëve nuk provohen
- Në **1** rast, pas ankesës së qytetarit është krijuar dosje për ndjekje penale



## Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

**101 ankesa**